

FEDERATA E SHENJËTARISË SPORTIVE E KOSOVËS

## RREGULLORJA

PËR REKORDET E FEDERATËS SË SHENJËTARISË SPORTIVE TË KOSOVËS

Prishtinë, 11.01.2011.

Në bazë të nenit 24 të Statutit të Federatës së Shenjëtarisë Sportive të Kosovës, Këshilli drejtues në mbledhjen e vetë të mbajtur më 11.01.2011, në Prishtinë aprovoi

## **RREGULLORËN**

### **PËR REKORDET E FEDERATËS SË SHENJËTARISË SPORTIVE TË KOSOVËS**

#### Neni 1

Rekordet e disiplinave të shenjëtarisë sportive pranohen në bazë të rregullave të ISSF-së dhe të Federatës së Shenjëtarisë Sportive të Kosovës.

#### Neni 2

Rekordet regjistrohen në konkurrencën individuale dhe ekipore për kategoritë e:

- seniorëve,
- senioreve,
- juniorëve,
- junioreve,
- pioniërëve dhe
- pionereve, në disiplinat që janë në programin e FSHSK-së.

#### Neni 3

Rekordet pranohen për rezultatet e arritura në:

- Kampionatet e Kosovës,
- Të gjitha garat ndërkombëtare ku marrin pjesë garuesit e së paku tri shteteve.

#### Neni 4

Rekordi ka kuptimin e rezultatit të arritur i cili është i njëjtë ose më i lartë se rezultati egzistues. Rekordi mund të jenë i parazues ose i thyer. Në të dy rastet garuesi ose ekipi janë bartës të rekordit. Garuesëve të kategorive në të reja u pranohen rekordet në kategorinë e vetë dhe në kategoritë më të larta në disiplinën e njëjtë, nëse rezultati është më i lartë, pa marrë parasyshë në cilën kategori ka marrë pjesë.

#### Neni 5

Rekordet regjistrohen ndaraz: për rezultatet bazë dhe për rezultatin bazë bashk me rezultatin final.

#### Neni 6

Rekordet janë të barabarta pa marrë parasyshë se a janë arritë në figurat elektronike ose në figurat e letrës, nëse ato janë sipas rregullave të ISSF-së ose të FSHSK-së.

## Neni 7

Për të qenë rekordet të verifikuara në Protokolin e garave vendore është i nevojshëm vlerësimi i:

- rregullshmerisë dhe kualitetit të poligonit,
- kualitetit dhe rregullshmerisë së figurave,
- niveli dhe kualiteti i organizimit të garave, dhe të
- ankesave dhe vërejtjeve.

## Neni 8

Nëse në një garë dy ose më shumë here barazohet ose thehet rekordi në të njëjtën discipline ose kategori, pranohet vetëm një rekord me rezultatin më të lartin.

## Neni 9

Për përcjelljen e rekordeve ngarkohet Komisioni profesional, Shërbimi profesional i Federatës dhe janë të obliguara që me marrjen e Buletinit dhe të Protokolit nga gara, menjëher ti regjistrojë rekordet e barazuara dhe të thyera.

## Neni 10

Regjistri i rekordeve publikohet në Buletinin numër 1. të të gjitha garave vendore në të cilat pranohen rekordet.

## Neni 11

Regjistri zyrtar i rekordeve në fund të vitit kalendarik u dërgohet të gjitha klubeve që janë anëtarë FSHSK-së.

## Neni 12

Verifikimin e rekordeve e bënë Këshilli drejtues i Federatës në propozim të Komisionit profesional në mbledhjen e pare të radhës.

## Neni 13

Mirënjohjet për rekordet e barazuara dhe të thyera gjatë vitit kalendarik i ndanë Këshilli drejtues i Federatës me Vendim të vacant.

## Neni 14

Rregullorja hynë në fuqi ditën e aprovimit.

Prishtinë, 11.01.2011.

KRYETARI i FSHSK-së,  
Ali Pllana, ecc i dipl.

